

## Ne fokus/ Juventus ben nje superoferte per Januzaj

nga AlbaniaSoccer

E martë, 24 Shtator 2013 22:20

---



Mediat angleze e bejne te afert transferimin e futbollistit me origjine shqiptare tek skuadra e Juventusit. Adnan Januzaj eshte ne planet e kampioneve te Italisë qe sipas mediave britanike kane bere nje oferte faraonike per te marre shërbimet kualitative te tij. Sipas "Daily Mail", bardhezinjte kane nisur te lëvizin konkretisht per talentin 18-vjeçar me pasaporte belge, i cili shihet edhe si pasardhesi i Ryan Giggs ne radhet e "Djajve te kuq". Moyes nuk eshte i gatshem t'i ofroje nje kontrate te re, gje te cilen synon ta bëje Marotta . Problem ne kete histori eshte kontrata qe Januzaj ka me United e cila skadon ne 2015. Juventus po studion situaten dhe po perpiqet te perfitoj.